



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

| | | |
|-------------|--|--------------|
| I. | Përmbledhje Ekzekutive | 2 |
| II. | Hyrje..... | 3-5 |
| | a. Objektivat dhe qëllimi | |
| | b. Identifikimi i çështjes | |
| | c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese | |
| | d. Përgjegjësitë e audituesve | |
| | e. Kriteret e Vlerësimit | |
| | f. Standartet e auditimit | |
| III. | Përshkrimi i auditimit..... | 5-21 |
| | III.1. Në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale Qarku Sarandë | 5-6 |
| | III.2. Në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit Dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale Qarku Lushnjë | 6-9 |
| | III.3 Në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit Dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale Qarku Kamëz – Vorë..... | 9-11 |
| | III.4. Në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier..... | 11-14 |
| | III.5. Në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë.. | 14-17 |
| | III.6. Në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan..... | 17-21 |
| IV. | Gjetje dhe Rekomandime..... | 21-35 |
| V. | Dokumentacion shoqërues..... | 36 |



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, gjatë auditimeve të evaduara në vitet 2018 dhe 2019 sipas programeve të auditimit me nr. 1270/2, datë 17.11.2018 dhe nr. 1270/4, datë 17.11.2018 miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Shtetit si dhe në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Kryetarit nr. 1, datë 04.11.2016 "*Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit*", në subjektet të audituar: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarkut Sarandë, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarkut Lushnjë Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kamëz – Vorë , ZVRPP Sarandë, ZVRPP Fier, dhe ZVRPP Elbasan , ka rezultuar si më poshtë:

- Janë rekomanduar gjithsej **329** masa, nga të cilat janë pranuar **258** masa, ose 78.5 % e masave të rekomanduara dhe nuk janë pranuar **71** masa, ose 21.5 %.

a- Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezulton: zbatuar plotësisht **207** masa, ose 80 %; pjesërisht **49** masa ose 19 %, dhe **2** masa të pazbatuara, ose 1 %.

b- Niveli i realizimit të masave, sipas llojit paraqitet si më poshtë:

b.1. Masa organizative, nga **230** të rekomanduara; janë pranuar **194** pra 84 %; janë zbatuar plotësisht **160** masa, ose 69.5 %; pjesërisht 32 masa ose 14 %; **2** masa të pranuar dhe të pazbatuara 2 ose 1 % dhe 36 masa të pa pranuar ose 15.5 %.

b.2. Masa shpërblim dëmi, nga **34** masa të rekomanduara, janë pranuar **24**, ose 70.5 %, janë zbatuar plotësisht 7 masa ose 20.5 %; janë zbatuar pjesërisht 17 masa ose 50 %, dhe 10 masa të pa pranuar ose 29.5 %.

Zbatimi në vlerë është si vijon: **34** masa të rekomanduara me vlerë **530,786.5 mijë lekë**, janë pranuar **24**, në vlerë **171,435.5 mijë lekë** ose 32.3 %, janë zbatuar 7 masa me vlerën 4,142 mijë lekë, janë zbatuar pjesërisht **17** masa me vlerën **33,149.5 mijë lekë**, ose 6 %, dhe 10 masa të pa pranuar me vlerë **359,351 mijë lekë, ose 67.7 %**.

b.3. Masa disiplinore, nga **65** masa të rekomanduara, janë pranuar 40 masa, ose 62.5 %, nga të cilat janë zbatuar 40 masa ose 62.5 %; nuk janë pranuar 25 masa, ose 38.5 %.

Në zbatim të kërkesave të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", subjektet kanë kthyer përgjigje brenda 20 ditëve në KLSH, mbi masat e mara për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportet përfundimtare të auditimit nga KLSH, sipas afateve të përcaktuara, dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*".



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

II. HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi, Drejtorinë Rajonale e ALUIZNI-t Qarkut Sarandë, Drejtorinë Rajonale e ALUIZNI-t Qarkut Lushnjë, Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Kamëz – Vorë, Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, dhe Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH", në zbatim të Programeve të Auditimit me nr. 1270/2, datë 17.11.2018 dhe nr. 1270/4, datë 17.11.2018, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 19.11.2018 deri në datë 20.01.2019, në subjektet Drejtorinë Rajonale e ALUIZNI-t Qarkut Sarandë, Drejtorinë Rajonale e ALUIZNI-t Qarkut Lushnjë, Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Kamëz – Vorë, Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, dhe Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan, mbi auditimet e kryera u krye auditimi "Mbi Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme",

nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. AM, përgjegjës grupi
2. HM, anëtar,
3. BP, anëtar,
4. DM, anëtar,
5. JA, anëtar.

- Objektivat dhe qëllimi i auditimit Kontrolli i Lartë i Shtetit ka audituar zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, në lidhje me konstatimet e gjetjeve nga auditimi në përputhje e zbatim me nenet 15 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";

-ligjin nr. 8379, datë 29.07.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave;

-ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktive në njësitë e sektorit publik"; ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në ndryshim dhe zbatim të tyre.

Qëllimi i auditimit është vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Identifikimi i Çështjeve

1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

1.1. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna

1.2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

1.3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

1.4. Realizimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmeve ekonomike, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar

1.5. Realizimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar.

2. Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit

Gjendja aktuale e çështjes së shqyrtuar, gjatë ushtrimit të auditimit në terren:

Për çështjet e shqyrtuara janë mbajtur nga një aktverifikim për çdo subjekt të audituar, janë zhvilluar ballafaqime gjatë auditimit në terren dhe në përfundim të tij me personat përgjegjës, argumentet, provat dhe faktet e trajtuara në observacionet dhe gjatë ballafaqimeve, janë reflektuar në raport auditimi për çdo subjekt të audituar.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:

Drejtorinë Rajonale e ALUIZNI-t Qarkut Sarandë, Drejtorinë Rajonale e ALUIZNI-t Qarkut Lushnjë, Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Kamëz – Vorë, në zbatim të ligji nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, ka për objektiv:

-Legalizimin e objekteve pa leje dhe shtesave vertikale dhe horizontale në objektet me leje ndërtimi".
-Kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore, ku është ngritur ndërtimi pa leje, sipas përcaktimeve të këtij ligji në favor të zaptuesit të pronës.

-Urbanizimin e zonave, blloqeve informale e të ndërtimeve informale, si dhe integrimin e tyre në zhvillimin territorial dhe infrastrukturor të vendit, duke përmirësuar kushtet e jetesës.

-Procedurat për realizimin e legalizimit të ndërtimeve informale/objekteve dhe shtesa informale në objektet me leje ndërtimi si dhe ngritjen e funksionimit të strukturave përgjegjëse për realizimin e tyre.
Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, dhe Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan, në zbatim të akteve administrative të lëshuara nga organet që e kanë në kompetencë, nga vendimet e gjykatave të formës së prerë që lidhen me pasuri të përfituara nga ligji i Urbanistikës i ndryshuar, ligji i legalizimeve, me vendime gjykate të formës së prerë, nga ligji i Privatizimit, Ligji për Shitblerjen e Trojeve etj, duke kryer bashkim e ndarje pasurish, duke kryer regjistrime fillestare të tokave bujqësore, duke regjistruar pasuri në zona të mbrojtura e zona turistike etj.

Përgjegjësitë e audituesve:

Grupi i auditimit të KLSH^{së}, për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, grupi i auditimit ka zbatuar Kodin e Parimet Etike të cilat drejtojnë përgjegjësitë profesionale të audituesit, si dhe Standardet e Miratuara të Auditimit ka patur në qendër të vëmendjes:

Kriteret e vlerësimit:

Në të gjitha fazat e auditimit sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit, në referencë me problematikën është patur si kriter vlerësues në radhë të parë ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" si dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" etj.

Në vlerësimin e mekanizmave të auditimit, janë marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVEVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

- kontrolli i zbatimit të afatit 20 ditor përcaktuar në pikën "j" të nenit 15 të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"
- vlerësimi i procesit të monitorimit të zbatimit të rekomandimeve dhe raportimi në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, brenda afatit prej 6 muaj nga data e dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"
- verifikimi i nxjerrjes së akteve administrative përkatësinë zbatim të pikës 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktive në njësitë e sektorit publik" kap. IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve",
- verifikimi i të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe procedurave të tjera ligjore me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit,

Standardet e auditimit

Rregullorja e Brendshme "Mbi Organizimin dhe Funksionimin Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit", miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH, Nr. 85, datë 30.06.2015; Rregullorja e Brendshme "Për procedurat e auditimit të KLSH" miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 107, datë 08.08.25017; Udhëzimi i Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016 "Mbi Procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit zbatimit rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit"; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t" (ISSAI), "Standardet e Kontrollit të KLSH", "Manualeve" si dhe udhëzimeve dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tyre.

III. PËRSHKRIMI I I AUDITIMIT

III.1. Në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale Qarku Sarandë.

Nga auditimi i ushtruar rezultoi:

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t, Qarku Sarandë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare" për periudhën 01.03.2014 deri me datë 30.06.2017 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.138, datë 30.09.2017 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 513/8, datë 05.10.2018, është konstatuar se janë lënë 32 rekomandime gjithsej, nga këto: 19 masa organizative, 1 masa dëmshpërblimi me vlerën 927.5 mijë lekë, dhe 12 masa disiplinore. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

1. Masa organizative janë rekomanduar 19, nga të cilat janë pranuar 19 masa dhe zbatuar plotësisht 12 masa. Kanë nisur procedurat për zbatim të 5 rekomandimeve dhe janë pa zbatuar 2 rekomandime.
2. Masa shpërblim dëmi është rekomanduar në një rast për vlerën 927.5 mijë lekë, nga të cilat është pranuar 1 dhe është arkëtuar vlera 97 mijë lekë është në proces arkëtimi vlera prej 830.5 mijë lekë.
3. Masa disiplinore janë rekomanduar 12 propozime për masa disiplinore, në kompetencë të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t Tiranë, nga të cilat janë pranuar dhe zbatuar të gjitha.

Në përfundim konstatohet se: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Qarku Sarandë *nuk ka zbatuar të gjitha rekomandimet e KLSH-së*, të dërguar me shkresën nr. 513/8, datë 05.10.2018. Nga auditimi i kryer



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, ose të papranuara:

1. Rekomandim: Për të gjithë poseduesit e lejeve të Legalizimit të trajtuara në faqet 19-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, dërguar me shkresën nr. 709/14, datë 26.11.2013, të cilat kanë rezultuar detyrime si diferencë nga mos llogaritja e saktë e tarifës së parcelës ndërtimore, të njoftohet ZVRPP Sarandë dhe ZQRPP për vendosjen e barrës (shënim hipotekor) deri në shlyerjen e detyrimit të nxjerrë.

Menjëherë

2. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Sarandë të marrë masa, që për rastet në vijim të procedurave të legalizimit të plotësojë formularin e lejes së legalizimit në përputhje me kërkesat e ligjit, duke përfshirë pjesën e verandës tek kondicionet e veçanta të lejes, në përputhje me sipërfaqet e miratuara me VKM.

Menjëherë

3. Rekomandimi:

Për 4 subjekte, të priten mandat dhe të nisen njoftimet për shlyerje detyrimi si më poshtë:

- Dosja nr. 865, datë 22.03.2005, me kërkues AZH, me leje legalizimi nr.1040227, datë 18.10.2016, mungon tarifa e shërbimit për ndërtimin informal dy kate në vlerë 16,000 lekë; Argumentohet se është shtesë banimi dhe nuk i llogaritet tarifë shërbimi

- Dosja nr. 73, datë 17.02.2005 me kërkues IB, me leje legalizimi nr. 1040087, datë 11.08.2016, nga rillogaritjet del se duhet të paguante për sipërfaqen prej 1230 m², ndërsa në fakt janë kryer pagesat për sipërfaqen 1166.2 m², pra me një diferencë prej 63.80 m² ose në vlerë 41,780 lekë; Argumentohet se llogaritja i është bërë sipas sipërfaqes miratuar në lejen e Legalizimit.

- Dosja nr. 935/1, datë 16.10.2014, me kërkues LÇ me leje legalizimi nr.1040332, datë 01.12.2016, nuk është llogaritur dhe kryer pagesa 8,000 lekë për çdo kat të ndërtimit e barabartë me 48,000 lekë, si dhe nuk është llogaritur penaliteti, duke i është shkaktuar një dëm buxhetit të shtetit për fondin e kompensimit në shumën 772,734 lekë; “nuk mund ti aplikohet penaltet pasi nuk është me leje ndërtimi që të llogaritet penaltet për pjesë n e daljes jashtë lejes së ndërtimit”

- Dosja nr. SR-45, datë 30.07.2015 nga shtetasja AA, dhe nr. SR-169, datë 27.08.2015 nga shtetasi MB, leje legalizimi nr. 1040062, datë 04.08.2016, nuk administrohet pagesa për tarifën e shërbimit në vlerën 8,000 lekë; Argumentohet se është shtesë banimi dhe nuk i llogaritet tarifë shërbimi

Gjithashtu për subjektet që nuk u janë bërë ë përlllogaritjet aplikimin e tarifave apo penalteteve, tu dërgohet shkresat në ZVRPP Sarandë , për të bërë kufizimin e pasurive deri në arkëtimin e detyrimeve financiare.

Menjëherë

III.2. Në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale Qarku Lushnjë

Nga auditimi i ushtruar rezultoi:

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t, Lushnjë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare” për periudhën 01.09.2015 deri me datë 31.12.2017 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.64, datë 30.06.2018 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

278/7, datë 30.06.2018, është konstatuar se janë lënë 29 rekomandime gjithsej, nga këto: 12 masa organizative, 8 masa dëmshpërblimi me vlerën 231,396 mijë lekë, dhe 9 masa disiplinore. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

1. Masa organizative janë rekomanduar 19, nga të cilat janë pranuar dhe zbatuar 7 masa. dhe janë pa pranuar dhe pa zbatuar 5 rekomandime.
2. Masa shpërblim dëmi janë rekomanduar 8 masa për vlerën 231,396 mijë lekë, nga të cilat nuk janë pranuar dhe nuk janë zbatuar 8 masa në vlerë 231,396 mijë lekë.
3. Masa disiplinore janë rekomanduar 12 masa, në kompetencë të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t Tiranë, nga të cilat janë pranuar dhe zbatuar të gjitha.

Në përfundim konstatohet se: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Qarku Lushnjë *nuk ka zbatuar të gjitha rekomandimet e KLSH-së*, të dërguar me shkresën 278/7, datë 30.06.2018. Nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, ose të papranuara:

1.Rekomandim: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Lushnjë të marrë masa që për lejet e legalizimit: me nr. 00000359, nr.99999643, nr. 00000152, nr. 99999457, nr. 99999627, nr.00000633, nr.00000332, të kërkojë anulimin ose shfuqizimin e këtyre lejeve të legalizimit, duke kërkuar në ZVRPP Lushnje nxjerrjen e urdhër kufizimi me emrat e përfituesve dhe objektet përkatëse, deri në rivlerësimin dhe plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Brenda muajit Korrik 2018 e në vijimësi

2. Rekomandimi: Drejtoria e ALUIZNI-t Lushnjë, të marrë masa për anulimin ose shfuqizimin e lejeve të legalizimit, nr.346, datë 26.09.2017, nr.125, datë 15.06.2017, nr.130, datë 20.06.2017, nr.234, datë 16.08.2017 nr.99999775, datë 06.03.2017, nr.99999208, datë 26.08.2016, nr.358, datë 29.09.2017, nr.99998919, datë 14.06.2016 nr.564, datë 20.12.2017, nr.78084, datë 27.11.2015 nr.99999908, datë 11.04.2017, nr.99999947, datë 24.04.2017 dhe objekti i legalizuar në emër të VA, duke kërkuar në ZVRPP Lushnje nxjerrjen e urdhër kufizimi **me emrat e përfituesve dhe objektet përkatëse, duke kërkuar masë kufizimi deri në rivlerësimin dhe plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.** Kjo masë të merret, pasi procedura e legalizimit të këtyre objekteve informale dhe pajisja me leje legalizimi, është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Menjëherë

3. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Lushnjë për nevoja të plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me leje të legalizimit të lëshuara, ka legalizuar objekte të cilat janë brenda brezit mbrojtës së vijës hekurudhore.

Të dërgojë shkresë në ZVRPP Lushnje që Lejet e Legalizimi me nr. 00000145, datë 28.06.2017, dhe nr.99999828, datë 24.03.2017 **me emrat e përfituesve dhe objektet përkatëse, duke kërkuar masë kufizimi deri në rivlerësimin dhe plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.**

Brenda muajit Korrik 2018 e vijimësi

4. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Lushnje në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, ti kërkojë Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjetikës, që për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

objektet informale të pajisura me leje legalizimi, nr.99998835, datë 18.05.2016 dhe nr.99998873, datë 26.05.2016 të fillojë procedurat, për rishikimin dhe shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim me ligjin dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Të dërgojë shkresë në ZVRPP Lushnje me emrat e përfituesve dhe objektet përkatëse, duke kërkuar masë kufizimi deri në rivlerësimin dhe plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Menjëherë

5. Rekomandimi: Drejtoria e ALUZINI-t Lushnje, të marrë masa për anulimin ose shfuqizimin e lejes së legalizimit, nr.99998568, datë 27.11.2015 të pajisura, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Të dërgohet shkresë në ZVRPP Lushnje me emrat e përfituesve dhe objektet përkatëse, duke kërkuar masë kufizimi, deri në rivlerësimin dhe plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", si dhe ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar dhe akteve ligjore e nënligjore të dalë në zbatim të tij, **nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit autorizues)**, të merren masa e të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohen në rrugë ligjore (*Padi Gjyqësore*), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim për shpërblimin e dëmit në **10 raste me vlerë 4,489,274 lekë**, si më poshtë:

1. Rekomandimi: Drejtoria e ALUIZNI-t Lushnjë të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore, arkëtimin e detyrimeve të papaguara për penalitetet për legalizimin e shtesave të subjekteve ndërtuese në vlerën totale prej 2,006,338 lekë, nga këto; *subjekti ID vlera 100,656 lekë, subjekti AN 1,367,165 lekë, subjekti HXH 190,455 lekë dhe subjekti TK 348,062 lekë.*

Brenda muajit Korrik 2018

2. Rekomandimi: Drejtoria e ALUIZNI-t Lushnjë të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore, arkëtimin e detyrimeve të papaguara për penalitetet për legalizimin e shtesave të subjekteve ndërtuese në vlerën totale prej 1,594,385 lekë. konkretisht:

- Leje legalizimi 99999101 datë 27-7-2016 ku nga fotot e objektit duket se kati i parë i tij është ambient shërbimi. Nga poseduesi është paguar, sipas njoftimit për pagesë nga Drejtoria e Aluiznit Lushnjë, me çmim favorizues, shuma *516,000 mijë lekë* nga të cilat 216,000 lekë dhe 300,000 bono privatizimi. Në fakt, nisur nga sa më sipër, për katin e parë, pagesa sipas çmimi i zonës prej 8954 lekë në këtë ZK duhej të ishte në vlerën 1,217,744 lekë ($136m \times 8954 \text{ lekë} = 1,217,744 \text{ lekë}$) duke shkaktuar një dëm prej $1,217,744 - 516,000 = 701,744 \text{ lekë}$;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

-dosja me numër 99999336, datë 29.09.2016 për të cilën ka dalë detyrimi 1,898,190 lekë dhe ka një diferencë në pagesë prej 254,841 lekë, vlerë e cila ulet sipas ligjit nëse fatura do të paguhej brenda 45 ditëve nga marrja e njoftimit, siç shihet në dosje ka 13 ditë vonesë në pagesë;
dosja me numër 99999697 datë 06.4.2017 ku nuk rezulton të jenë shlyer detyrimet për penalitetet e legalizimit të shtesave të subjektit ndërtues në vlerën prej 2% të çmimit minimal fiskal për çdo m² sipërfaqe shtesë për banim 267,788 lekë (427m² X 31,357 lekë X 2%);
dosja me numër 99999347 datë 20.09.2016 për shtesa anësore në një pallat, me sipërfaqe totale prej 236 m² për të cilat nuk rezultojnë të jenë shlyer detyrimet për penalitetet e legalizimit të shtesave të subjektit ndërtues në vlerën prej 2% të çmimit minimal fiskal, për çdo m² sipërfaqe shtesë për banim duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 370,012 lekë

Menjëherë

3. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Lushnje të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për llogaritjen, saktësimin dhe *arkëtimin e vlerës 204,760 lekë*, ardhur nga mos aplikimit të penalitetit për lejen e legalizimit nr.00000199, datë 08.08.2017.

Brenda muajit Shtator 2018

4. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Lushnje të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për llogaritjen, saktësimin dhe arkëtimin e vlerës **379,419 lekë, në përputhje me kërkesat** e Ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar ardhur nga mos aplikimit të penalitetit për lejen e legalizimit me nr.99998650, datë 29.01.2016.

Brenda muajit Shtator 2018

III.3. Në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale Kamëz-Vorë.

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t, Qarku Kamëz-Vorë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare" për periudhën 01.01.2015 deri me datë 30.09.2017 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.12, datë 28.02.2018 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1040/10, datë 28.02.2018, është konstatuar se janë lënë 44 rekomandime gjithsej, nga këto: 22 masa organizative, 4 masa dëmshpërblimi me vlerën 1,481 mijë lekë, dhe 18 masa disiplinore. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

1. Masa organizative janë rekomanduar 22, nga të cilat janë pranuar dhe zbatuar 18 masa. dhe janë pa pranuar dhe pa zbatuar 4 rekomandime.
2. Masa shpërblim dëmi janë rekomanduar 4 masa për vlerën 1,481 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar dhe janë zbatuar 4 masa në vlerë 1,481 mijë lekë.
3. Masa disiplinore janë rekomanduar 18 masa, në kompetencë të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t Tiranë, nga të cilat janë pranuar dhe zbatuar 15 masa si dhe nuk janë pranuar e nuk janë zbatuar 3 masa.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

Në përfundim konstatohet se: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Kamëz-Vorë *nuk ka zbatuar të gjitha rekomandimet e KLSH-së*, të dërguar me shkresën nr. 1040/10, datë 28.02.2018. Nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara:

1. Rekomandim: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Vorë-Kamëz te rivlerësojë lejen e legalizimit me nr. 662979 datë 19.01.2015 proceduesi KP për 131.1 m² të mare me tepër dhe të ndjekë procedurat sipas ligjit .

Menjëherë

2. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Kamëz - Vorë të marrë masa që të kërkojë nga subjektet: **MS pajisur me lejë e legalizimit me nr. 667059 datë 26.08.2015 dhe XHH pajisur me lejë e legalizimit me nr. 666398 datë 27.07.2015**, plotësimin e dosjes me dokumentet e nevojshme, si dhe për të ardhmen të ndjekë procedurat ligjore dhe të qartësojë çdo veprim të sektorëve përkatës për veprimet e kryera në përputhshmëri me ligjin për legalizimin e objekteve informale.

Menjëherë

3. Rekomandimi: Drejtoria ALUIZNI Kamëz-Vorë të marrë masa të menjëhershme për të administruar dhe mbajtur evidencë të saktë dhe në mënyrë të vazhdueshme, mbi sipërfaqet e lira në pronësi shtet lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që kanë, të njoftojë me shkresë institucionet vendore dhe ato kompetente si Bashkinë Kamëz dhe Vorë. Të vendosë në dispozicion të këtyre NJVQV-ve listën me sipërfaqe të lira, konfirmimin e tyre në pronësi shtet dhe dërgimin NJVQV- ve për ti vlerësuar e përdorur si ambiente publike, etj.

-Të argumentohet dhe të merret deklarata noteriale nga individët lidhur me legalizimin e sipërfaqes së parcelës ndërtimore, mbi masën e trefishit të bazës së ndërtimit, pavarësisht se nuk është më e madhe se 500 m².

Menjëherë

4. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale ALUIZNI Kamëz-Vorë të zbatojë proceduar e legalizimit të objekteve të dyta brenda rrethimit të objekteve kryesore:

-leje legalizimi 70207397, datë 10.04.2017, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 500 m², në ZK 2066, pasuria 347/14/2, nuk është legalizuar ngrehina funksionale 1 kat me 40 m² dhe 60 ml mur rrethues brenda sipërfaqes parcelës ndërtimore;

-leje legalizimi nr. 70207266, datë 31.3.2017, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 180 m² në ZK 3992, pasuria 2/296, nuk është legalizuar ngrehina funksionale ose muri rrethues 40 ml pasqyruar në vet deklarimin datë 17.11.2006 brenda sipërfaqes parcelës ndërtimore.

Në të ardhmen të mbajë parasysh legalizimin e ngrehina funksionale brenda sipërfaqes parcelës ndërtimore.

Menjëherë

B. MASA DISIPLINORE



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa "d" dhe "e" dhe nenet 37, **141, dhe 153** të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, si dhe në kontratën individuale të punës **ti kërkojmë Drejtorit të ALUIZNI-t Kamëz-Vorë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga **"Vërejtje me shkrim"** deri në **"Largim nga puna"**, për këta punonjës:

II. Masa "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna" deri në "Largim nga Puna (zgjdhje e kontratës)", për punonjësit, si më poshtë:

1. Znj. NK, me detyrë specialiste e legalizimit.
2. Znj. MÇ, me detyrë specialiste e legalizimit
3. Z. BK, me detyrë specialiste e legalizimit.

Menjëherë

III.4. Në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier

Nga auditimi i ushtruar rezultoi:

Nga auditimi i ushtruar në ZVRPP Fier, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, "Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare" për periudhën 01.07.2015 deri më 01.03.2018 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 66, datë 30.06.2018 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 271/7 prot, datë 10.07.2018, është konstatuar se janë lënë 63 rekomandime gjithsej, nga këto: 43 masa organizative, 7 masë dëmshpërblimi me vlerën 136,657 mijë lekë, dhe 13 masa disiplinore. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

1. **Masa organizative** janë rekomanduar 43, nga të cilat janë pranuar 32, dhe zbatuar 22 rekomandime, janë në proces zbatimi 10 rekomandime, ndërsa **11 rekomandime nuk janë zbatuar.**
2. **Masa shpërblim dëmi** është rekomanduar 7 masë, për vlerën 136,657 mijë lekë, masë e cila janë pranuar 7, janë në proces 7 masa në vlerë 2,513 mijë lekë.
3. **Masa disiplinore** janë rekomanduar 13 masa, në kompetencë të ZQRPP. Lidhur me zbatimin e tyre ZQRPP ka zbatuar 3 masa, dhe nuk janë zbatuar 10 masa disiplinore.

Në përfundim konstatohet se: Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, *nuk ka zbatuar të gjitha rekomandimet e KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 271/7, datë 10.07.2018.* Nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, ose të papranuara:

1. Rekomandimi: Regjistruesi i ZVRPP Fier të marrë masa, në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara në ZK 3612, Topojë, sipas AMTP të lëshuara në vitin 1992-1995, në emër të subjekteve përkatëse: në 300 raste (AMTP nga nr. 5279 deri nr. 5579), në ZK 3612, Topojë, deri**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

në verifikimin e elementeve të formës dhe përmbajtjes, si dhe të aplikojë një standard verifikimi dhe regjistrimi për gjithë AMTP.

Brenda muajit Shtator 2018 dhe vijimësi

2. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Fier të marrë masa **duke vendosur masë kufizimi për pasuritë në zonat kadastrale nr. 2599 "Marinëz", 3015, "Pojan" dhe 1940 "Hasturkas",** në rastet kur nuk janë lëshuar certifikata pronësie dhe dokumentacioni bazë për regjistrim janë AMTP-të e arkivuara sipas Vendimit nr.556, datë 23.10.2000, pa shkresë përcjellëse, **për 630 AMTP, të cilat nuk plotësojnë elementët e formës dhe të përmbajtjes,** sepse janë pa asnjë vulë dhe një pjesë të pa nënshkruara nga Kryetari i Komisionit të Tokës, të pakonfirmuara nga Këshilli i Qarkut dhe Zyra e Kadastrës, duke dërguar në Komisionin Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë (KV) Prefekti Fier, dokumentacionin e AMTP-ve, për të 3 zonat kadastrale të përmendura më sipër, për trajtim, vendimarrje në verifikimin e plotë të elementeve formës e përmbajtjes, përcjelljen pranë gjykatës, deri në kthim të përgjigjes nga KV dhe vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, mbi vlefshmërinë ligjore të titujve të pronësisë.

Brenda Muajit Shtator 2018

3. Rekomandimi: Regjistruesi i ZVRPP Fier të marrë masa, **duke vendosur masë kufizimi për pasuritë në zonat kadastrale: nr.8533 "Fier-Qytet", nr.2636 "Mbrostar-Ura", në 30 raste, ku 20 raste në ZK nr.8533 "Fier-Qytet"** sipas referencave nr.014925, 015445, 014934, 015883, 014283, 014288, 014308, 014308, 014416, 014585, 014623, 014174, 014080, 013204, 013190, 013167, 013705, 013699, 013681, 013679 dhe **10 raste në ZK nr. 2636 "Mbrostar-Ura",** sipas referencave 02411, 02419, 02442, 02450, 02462, 02492, 02548, 02555, 02233, 02424, **deri në arkëtimin e plotë nga përfituesit të vlerës së investimit prej 120,173,393 lekë. Në të ardhmen të mos kryhen regjistrime të pasurive të përfituara nga legalizimi në llojin ndërtesë pronë "Shtet", me përjashtim të rasteve kur janë shembur dhe të plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor,** deklarata noteriale të poseduesit dhe dokumentacionin justifikues që paraqet procedurat për pasqyrimin e gjendjes ekzistuese në inventarin e pronave të paluajtshme të shtetit, sipas ligjit dhe akteve nënligjore.

Brenda muajit Shtator 2018 dhe në vijimësi

4. Rekomandimi: Regjistruesi i ZVRPP Fier të marrë masa, **duke vendosur kufizimin për pasuritë nr. 116/10 "Zallishte", nr. 114/3 "Tokë e pafrytshme", nr.16/15 "Lulishte", Zonën Kadastrale nr. 2288 "Kryegjatë" dhe nr. 2443 "Libofshë",** sipas referencave 0028, 0025, 0869, ku sipërfaqet përkatëse të këtyre pasurive, janë ulur nga ana e Komunës Dërmenas dhe bashkisë Fier, dhe regjistruar më pak **18960.5 m² tokë "Zallishte", "PF", "Lulishte",** pronë shtet, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor për kalimin e pasurive të mësipërme në sipërfaqet e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, ose duke marrë konfirmim me VKM për këtë ulje sipërfaqe **prej 18960.5 m².**

Brenda Muajit Shtator 2018

5. Rekomandimi: Regjistruesi i ZVRPP Fier të marrë masa, duke vendosur kufizimin për pasuritë sipas referencave nr. 015643, 0754, 0187, ku janë kryer regjistrime të njëjësive shtetërore të privatizuar (kalim prej hipotekës në sistemin e regjistrimit), në mungesë të dokumentit të marrëdhënies me truallin (kontratën e qirasë ose të shitblerjes), të plan vendosjes dhe të dokumenteve financiare të pagesës së objektit dhe truallit, duke shkaktuar një dëm ekonomik gjithsej prej **1,932,916 lekë,** deri në plotësim të dokumentacionit tekniko-ligjor.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

Brenda muajit Shtator 2018

6. Rekomandimi: Regjistruesi i ZVRPP Fier të marrë masa, në bazë të pikës "1" neni 5 dhe neni 59 të ligjit nr.33/2012, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", i ndryshuar, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë deri në kalimin e sipërfaqeve të tepërta në statusin "shtet":

-Pasuria nr.10/1, vol.9, fq.164 ZK 3532 Fshati Strum, Njësia Administrative Strum, Bashkia Roskovec, për një sipërfaqe prej 5000 m² në pronësi të BK,

- Pasuria nr. 29/33, vol.6, fq.9, me sip.4000 m² ZK 3981, në fshatin Sheq Njësia Administrative Qendër, Bashkia Fier, e llojit arë, në pronësi të subjektit LLD.

7. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Fier të marrë masa, që në bazë të pikës "1" neni 5 dhe neni 59 të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të rikërkojë që të arkëtohet në rrugë ligjore shuma 72,354 lekë nga z.K.Z.

Brenda muajit Shtator 2018

- **Pasuria nr.8/216**, volumni 29, faqe 218, ZK 8642, në pronësi të investitorit "AM" shpk, për sipërfaqen totale të përbashkët prej **244 m²**, duke mos llogaritur taksën e kalimit të pronësisë në vlerën prej në vlerën **170,800 lekë**;

- **Pasuria nr.23/197**, volumni 32, faqe 181, në pronësi të investitorit "R", për sipërfaqen totale të përbashkët prej **210 m²**, duke mos llogaritur taksën e kalimit të pronësisë në vlerën prej në vlerën **147,000 lekë**, si dhe nuk është llogaritur e ndalur taksa e kalimit të pronësisë, për sipërfaqen totale të ballkoneve prej **482 m²**, në vlerën prej në vlerën **337,400 lekë**;

- **Pasuria nr.15/233**, volumni 22, faqe 101, ZK 8642, në pronësi të investitorit "ASH dhe ML", për sipërfaqen totale të përbashkët prej **242 m²**, duke mos llogaritur taksën e kalimit të pronësisë në vlerën prej në vlerën **197,400 lekë**;

- **Pasuria nr.22/53**, volumni 17, faqe 57, ZK 8642, në pronësi të investitorit "A-A" shpk, për sipërfaqen totale të përbashkët prej **218 m²**, duke mos llogaritur taksën e kalimit të pronësisë në vlerën prej në vlerën **152,600 lekë**;

- **Pasuria nr.7/96**, volumni 28, faqe 55, në pronësi të investitorit "R", për sipërfaqen totale të përbashkët prej **220 m²**, duke mos llogaritur taksën e kalimit të pronësisë në vlerën prej në vlerën **154,000 lekë**, si dhe nuk është llogaritur e ndalur taksa e kalimit të pronësisë, për sipërfaqen totale të ballkoneve prej **430 m²**, në vlerën prej në vlerën **301,000 lekë**;

Menjëherë

9. Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë të marrë masa, në bazë të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

në dispozitat ligjore përkatëse, në bashkëpunim me grupet e interesit, të vendosen afate por jo të bllokohen veprimet dhe transaksionet që kanë subjektet dhe personat posedues të pasurive në volum 29, faqe 126, me referencë nr.4411, datë 25.09.2015, regjistruar objekti pallat pasuria nr.24/343, si dhe të kërkohet sipas procedurave administrative arkëtimi i detyrimeve të papaguara për pasuritë e pasqyruara, deri në regjistrimin e ambienteve të përbashkëta përkatëse dhe kryerjen e detyrimeve të papaguara në vlerën totale 402,300 lekë.

Menjëherë

2. Në Drejtorinë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lushnjë.

1.Rekomandim: Drejtorinë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lushnjë të marrë masa që në zbatim të nenit 27 të ligjit i ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", për lejet e legalizimit: me nr. 00000359, nr.99999643, nr. 00000152, nr. 99999457, nr. 99999627, nr.00000633, nr.00000332, të kërkojë anulimin ose shfuqizimin e këtyre lejeve të legalizimit, dhe në zbatim të nenit 27 të ligjit i ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", të kërkojë nxjerrjen e urdhër kufizimi me emrat e përfituesve dhe objektet përkatëse, deri në rivlerësimin dhe plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Menjëherë

2. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lushnjë, të marrë masa për anulimin ose shfuqizimin e lejeve të legalizimit, nr.346, datë 26.09.2017, nr.125, datë 15.06.2017, nr.130, datë 20.06.2017, nr.234, datë 16.08.2017 nr.99999775, datë 06.03.2017, nr.99999208, datë 26.08.2016, nr.358, datë 29.09.2017, nr.99998919, datë 14.06.2016 nr.564, datë 20.12.2017, nr.78084, datë 27.11.2015 nr.99999908, datë 11.04.2017, nr.99999947, datë 24.04.2017 dhe objekti i legalizuar në emër të Vullnet Arapi, dhe në zbatim të nenit 27 të ligjit i ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", duke nxjerrjen e urdhër kufizimi **me emrat e përfituesve dhe objektet përkatëse, duke kërkuar masë kufizimi deri në rivlerësimin dhe plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.** Kjo masë të merret, pasi procedura e legalizimit të këtyre objekteve informale dhe pajisja me leje legalizimi, është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Menjëherë

3. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lushnjë për nevoja të plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me leje të legalizimit të lëshuara, ka legalizuar objekte të cilat janë brenda brezit mbrojtës së vijës hekurudhore.

Për Lejet e Legalizimi me nr. 00000145, datë 28.06.2017, dhe nr.99999828, datë 24.03.2017 me emrat e përfituesve dhe objektet përkatëse, duhet kërkuar masë kufizimi deri në rivlerësimin dhe plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Menjëherë

4. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lushnjë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, ti kërkojë Ministrisë Drejtësisë, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi, nr.99998835, datë 18.05.2016 dhe nr.99998873, datë 26.05.2016 të fillojë procedurat, për rishikimin dhe shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim me ligjin dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

Të veprjës që me emrat e përfituesve dhe objektet përkatëse, për masë kufizimi deri në rivlerësimin dhe plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Menjëherë

5. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lushnje, të marrë masa për anulimin ose shfuqizimin e lejes së legalizimit, nr.99998568, datë 27.11.2015 të pajisura, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Të veprjës që objektet përkatëse, me masë kufizimi, deri në rivlerësimin dhe plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Menjëherë

3. Në Drejtorinë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz-Vorë.

1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz-Vorë të rivlerësojë lejen e legalizimit me nr. 662979 datë 19.01.2015 proceduesi KP për 131.1 m² të mare me tepër dhe të ndjekë procedurat sipas ligjit .

Menjëherë

2. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz-Vorë të marrë masa që të kërkojë nga subjektet: **MS pajisur me lejë e legalizimit me nr. 667059 datë 26.08.2015 dhe XHH pajisur me lejë e legalizimit me nr. 666398 datë 27.07.2015**, plotësimin e dosjes me dokumentet e nevojshme, si dhe për të ardhmen të ndjekë procedurat ligjore dhe të qartësojë çdo veprim të sektorëve përkatës për veprimet e kryera në përputhshmëri me ligjin për legalizimin e objekteve informale.

Menjëherë

3. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz-Vorë të marrë masa të menjëhershme për të administruar dhe mbajtur evidencë të saktë dhe në mënyrë të vazhdueshme, mbi sipërfaqet e lira në pronësi shtet lënë jashtë procesit të legalizimit dhe të pamundura për parcelizim për vetë pozicionin gjeografik që kanë, të njoftojë me shkresë institucionet vendore dhe ato kompetente si Bashkinë Kamëz dhe Vorë. Të vendosë në dispozicion të këtyre NJVQV-ve listën me sipërfaqe të lira, konfirmimin e tyre në pronësi shtet dhe dërgimin NJVQV- ve për ti vlerësuar e përdorur si ambiente publike, etj.

-Të argumentohet dhe të merret deklarata noteriale nga individët lidhur me legalizimin e sipërfaqes së parcelës ndërtimore, mbi masën e trefshit të bazës së ndërtimit, pavarësisht se nuk është më e madhe se 500 m².

Menjëherë

4. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz-Vorë të zbatojë proceduar e legalizimit të objekteve të dyta brenda rrethimit të objekteve kryesore:

-leje legalizimi 70207397, datë 10.04.2017, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 500 m², në ZK 2066, pasuria 347/14/2, nuk është legalizuar ngrehina funksionale 1 kat me 40 m² dhe 60 ml mur rrethues brenda sipërfaqes parcelës ndërtimore;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

-leje legalizimi nr. 70207266, datë 31.3.2017, për parcelën ndërtimore me sipërfaqe 180 m² në ZK 3992, pasuria 2/296, nuk është legalizuar ngrehina funksionale ose muri rrethues 40 ml pasqyruar në vet deklarinimin datë 17.11.2006 brenda sipërfaqes parcelës ndërtimore.

Në të ardhmen të mbajë parasysh legalizimin e ngrehina funksionale brenda sipërfaqes parcelës ndërtimore.

Menjëherë

4. Në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier

1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier të marrë masa, në bazë të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara në ZK 3612, Topojë, sipas AMTP të lëshuara në vitin 1992-1995, në emër të subjekteve përkatëse: në 300 raste (AMTP nga nr. 5279 deri nr. 5579), në ZK 3612, Topojë, deri në verifikimin e elementeve të formës dhe përmbajtjes, si dhe të aplikojë një standard verifikimi dhe regjistrimi për gjithë AMTP.**

Menjëherë

2. Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier të marrë masa **duke vendosur masë kufizimi për pasuritë në zonat kadastrale nr. 2599 "Marinëz", 3015, "Pojan" dhe 1940 "Hasturkas",** në rastet kur nuk janë lëshuar certifikata pronësie dhe dokumentacioni bazë për regjistrim janë AMTP-të e arkivuara sipas Vendimit nr.556, datë 23.10.2000, pa shkresë përcjellëse, **për 630 AMTP, të cilat nuk plotësojnë elementët e formës dhe të përmbajtjes,** sepse janë pa asnjë vulë dhe një pjesë të pa nënshkruara nga Kryetari i Komisionit të Tokës, të pakonfirmuara nga Këshilli i Qarkut dhe Zyra e Kadastrës, duke dërguar në Komisionin Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë (KV) Prefekti Fier, dokumentacionin e AMTP-ve, për të 3 zonat kadastrale të përmendura më sipër, për trajtim, vendimarrje në verifikimin e plotë të elementeve formës e përmbajtjes, përcjelljen pranë gjykatës, deri në kthim të përgjigjes nga KV dhe vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, mbi vlefshmërinë ligjore të titujve të pronësisë.

Menjëherë

3. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier të marrë masa, **duke vendosur masë kufizimi për pasuritë në zonat kadastrale: nr.8533 "Fier-Qytet", nr.2636 "Mbrostar-Ura", në 30 raste, ku 20 raste në ZK nr.8533 "Fier-Qytet" sipas referencave nr.014925, 015445, 014934, 015883, 014283, 014288, 014308, 014308, 014416, 014585, 014623, 014174, 014080, 013204, 013190, 013167, 013705, 013699, 013681, 013679 dhe 10 raste në ZK nr. 2636 "Mbrostar-Ura", sipas referencave 02411, 02419, 02442, 02450, 02462, 02492, 02548, 02555, 02233, 02424, deri në arkëtimin e plotë nga përfituesit të vlerës së investimit prej 120,173,393 lekë. Në të ardhmen të mos kryhen regjistrime të pasurive të përfituara nga legalizimi në llojin ndërtesë pronë "Shtet", me përjashtim të rasteve kur janë shembur dhe të plotësimin të dokumentacionit tekniko-ligjor, deklarata noteriale të poseduesit dhe dokumentacionin justifikues që paraqet procedurat për pasqyrimin e gjendjes ekzistuese në inventarin e pronave të paluajtshme të shtetit, sipas ligjit dhe akteve nënligjore.**

Menjëherë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

4. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier të marrë masa, duke vendosur kufizimin për pasuritë nr. 116/10 "Zallishte", nr. 114/3 "Tokë e pafrytshme", nr.16/15 "Lulishte", Zonën Kadastrale nr. 2288 "Kryegjatë" dhe nr. 2443 "Libofshë", sipas referencave 0028, 0025, 0869, ku sipërfaqet përkatëse të këtyre pasurive, janë ulur nga ana e Komunës Dërmenas dhe bashkisë Fier, dhe regjistruar më pak 18960.5 m² tokë "Zallishte", "PF", "Lulishte", pronë shtet, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor për kalimin e pasurive të mësipërme në sipërfaqet e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, ose duke marrë konfirmim me VKM për këtë ulje sipërfaqe prej 18960.5 m².

Menjëherë

5. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier të marrë masa, duke vendosur kufizimin për pasuritë sipas referencave nr. 015643, 0754, 0187, ku janë kryer regjistrime të njësisve shtetërore të privatizuar (kalim prej hipotekës në sistemin e regjistrimit), në mungesë të dokumentit të marrëdhënieve me truallin (kontratën e qirasë ose të shitblerjes), të plan vendosjes dhe të dokumenteve financiare të pagesës së objektit dhe truallit, duke shkaktuar një dëm ekonomik gjithsej prej 1,932,916 lekë, deri në plotësim të dokumentacionit tekniko-ligjor.

Menjëherë

6. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier të marrë masa, në bazë të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë deri në kalimin e sipërfaqeve të tepërta në statusin "shtet":

-Pasuria nr.10/1, vol.9, fq.164 ZK 3532 Fshati Strum, Njësia Administrative Strum, Bashkia Roskovec, për një sipërfaqe prej 5000 m² në pronësi të BK,

- Pasuria nr. 29/33, vol.6, fq.9, me sip.4000 m² ZK 3981, në fshatin Sheq Njësia Administrative Qendër, Bashkia Fier, e llojit arë, në pronësi të subjektit LLD.

Menjëherë

7. Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier të marrë masa, që në bazë të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të rikërkojë që të arkëtohet në rrugë ligjore shuma 72,354 lekë nga z. K. Z.

Menjëherë

8. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier të marrë masa, që në bazë të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi dhe kërkojë KVTTP, verifikimin e plotë të pasurive të trajtuar sipas AMTP nr. 6032 por e disponueshme nga dy qytetarë: AB dhe BZ.

Menjëherë

9. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier të marrë masa, që në bazë të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkojë KVTTP verifikimin e plotë të pasurive të trajtuar sipas AMTP nr.14965/1, datë 16.12.1995 të disponueshme nga qytetari AJ.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

10. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier të marrë masa, që në bazë të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkojë KVTTP, verifikimin e plotë të pasurive të trajtuar sipas AMTP nr. 15277, datë 20.07.1995 të disponueshme nga qytetari HT.**

Menjëherë

11. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier të marrë masa, që në bazë të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kërkojë KVTTP, verifikimin e plotë të pasurive të trajtuar sipas AMTP nr. 18730, datë 06.08.2001 të disponueshme nga qytetari SS Fshati Radostinë Njësia Administrative Dermenas.**

Menjëherë

5. Në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan.

1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa dhe të rakordojë sipërfaqen e ndërtimit për diferencën -44.5 m^2 , pasi paraqiten mospërputhje të sipërfaqeve ndërtimit me veprimet e bashkimit e ndarjes së pasurisë 29/329 dhe lejes legalizimit datë 26.10.2016 për pasurinë nr. 29/255, ZK 8523.

Menjëherë

2. Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të kufizojë pasurinë nr. 14/8/1, ZK 2876, pasi leja e legalizimit nr. 9986634 datë 22.06.2016 flet për pasurinë 14/8/2, e cila është shpronësuar, duke rakorduar me ALUIZNI për sistemimin e veprimeve hipotekore.

Menjëherë

3. Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa, në bazë të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara mbi normën ligjore, pasqyruar në mënyrë të detajuar në tabelën nr.1 të emërtuar "Pasuritë e regjistruara sipas "Listës emërore të pronarëve të trojeve dhe ndërtesave 001" në ZK 1742, fshati Gjinar, dhe ZK 3445, fshati Shushicë, me sipërfaqe trojesh mbi normën ligjore", si dhe të veçoj në pronë "Shtet" sipërfaqet mbi normë.**

Menjëherë

4. Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masat që në bazë të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë e regjistruara në ZK 8522 sipas referencës nr. 04260, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor. Gjithashtu, ZVRPP Elbasan të marrë masa që mos të regjistrojë objekte të privatizuara në kundërshtim me Ligjin nr. 7512, datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarur dhe privatizimit" i ndryshuar, pa dokumentacionin e detyrueshëm të përcaktuar në dispozitat përkatëse ligjore.**

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

5. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa, në bazë të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë e regjistruar sipas referencës nr.04260, në ZK 8522, deri në arkëtimin e detyrimit të qirasë në vlerën 2,879,712 lekë, konstatuar si rezultat mos përcaktimit të marrëdhënieve të pronësisë së truallit.**

Menjëherë

6. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa që në bazë të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për 8 pasuritë e regjistruara, në ZK 1146, 1147, sipas referencave nr. 1104, 1099, 1133, 1059, 1140, 1074, 373, 398, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor deklaratat personale, ku merret përsipër përgjegjësia për çdo pasojë, që mund të rrjedhë nga shkaqe natyrore dhe/ose nga përdorimi i banesës.**

Menjëherë

7. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa në 3 raste, në zonat kadastrale 1147, "Belsh Qendër", dhe 1302 "Bujaras", ZK 2026, Kajan, sipas referencave nr. 01009 dhe 00037, 0068, bazuar në shkeljet e konstatuara të vendosë masë kufizim deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor. Gjithashtu, në të ardhmen të mos pranojë për regjistrim pasuri të paluajtshme, në kushtet e ndryshimit të zërave kadastralë pa miratimin e institucioneve përkatës sipas ligjit.

Menjëherë

8. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa që në bazë të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara sipas pasurive të ZK 1146, Belsh Hysaj: nr. 40/12/1, 40/12/2, 23/18, 20/8, 20/11, 42/9/1, 40/15, 80/11, 62/2, 80/6/1, 82/13, 83/1/31, 81/2/1, 821/1, 87/14, 47/60, 33/2/1, 48/18, 48/20, 42/6, 42/8, 48/35, 23/6/1, 23/9/1, 71/10, 40/10/1, 23/8, 23/7, 23/14, 187/6, 23/13/1, 82/12, 71/39, 56/3, 48/47, 81/1, 83/1/15+1, 48/32, 82/6, 80/10, 47/66, 22/1, 22/1; ZK 1302 "Bujaras" 298/33, 298/34, 347/23, 347/24, deri në plotësimin e kushteve dhe dokumentacionit tekniko-ligjor dhe kalimit në pasuri pronë "Shtet" të sipërfaqes prej 3577 m² Truall.**

Menjëherë

9. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të marrë masa që në bazë të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara sipas pasurive të ZK 1146 "Belsh (Hysaj), në 14 raste, për një sipërfaqe të përgjithshme 1898 m², sipas pasurive: nr. 42/9/1 (87 m²), 80/11(118 m²), 80/6/1 (136 m²), 82/13 (690 m²), 81/2/1(112 m²), 48/18(73 m²), 23/9/1 (120 m²), 23/14 (100 m²), 48/47 (80 m²), 81/1 (88 m²), 82/6 (83 m²), 22/1(108 m²); ZK 1302 "Bujaras": pasuritë 298/33(63 m²), 347/24(40 m²), janë regjistruar për herë të dytë pasuri "Ndërtesë", në një kohë që kanë përfutuar një pasuri të llojit "Ndërtesë", deri në plotësimin e kushteve dhe dokumentacionit tekniko-ligjor .**

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

10. Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, Regjistruesi, të shtojë në kufizimin krahas kredisë bankare dhe për mos shlyerjen e detyrimeve financiare taksës ndikimit infrastrukturës në vlerën **647,230 lekë** për objektin e ri, deri në sigurimin e vërtetimit të pushtetit vendor, për pasurinë nr. 15/363, ZK 8523, lagjja "Hekurudha.

Menjëherë

11. Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa, në bazë të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara sipas referencës nr.04260, në ZK 8522, deri në arkëtimin e detyrimit të qirasë në vlerën 2,879,712 lekë, konstatuar si rezultat mos përcaktimit të marrëdhënieve të pronësisë së truallit.

Menjëherë

12. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa dhe të korrigjojë dhe sistemojë në KPP, vol 43, faqe 243, Seksioni B, kolona "sipërfaqe ndërtese" sipërfaqen ndërtimore (bazë) për 8,3 m² tepër, pasi është regjistruar gabimisht 116,1 m² në vend të 107,8 m² që duhej, sipas lejes legalizimit nr. 8596875, datë 03.08.2017, për objektin godinë banimi 2-kat, pasuria nr. 27/216, ZK 8523.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Në Drejtorinë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lushnjë.

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", si dhe ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar dhe akteve ligjore e nënligjore të dalë në zbatim të tij, **nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit autorizues)**, të merren masa e të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohen në rrugë ligjore (*Padi Gjyqësore*), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim për shpërblimin e dëmit në **10 raste me vlerë 4,489,274 lekë**, si më poshtë:

1. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lushnjë të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore, arkëtimin e detyrimeve të papaguara për penalitetet për legalizimin e shtesave të subjekteve ndërtuese në vlerën totale prej 2,006,338 lekë, nga këto; *subjekti ID vlera 100,656 lekë, subjekti AN, 1,367,165 lekë, subjekti HXH 190,455 lekë dhe subjekti TK 348,062 lekë.*

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

2. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lushnjë të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore, arkëtimin e detyrimeve të papaguara për penalitetet për legalizimin e shtesave të subjekteve ndërtuese në vlerën totale prej 1,594,385 lekë. konkretisht:

- Leje legalizimi 99999101 datë 27-7-2016 ku nga fotot e objektit duket se kati i parë i tij është ambient shërbimi. Nga poseduesi është paguar, sipas njoftimit për pagesë nga Drejtoria e Aluiznit Lushnjë, me çmim favorizues, shuma 516,000 mijë lekë nga të cilat 216,000 lekë dhe 300,000 bono privatizimi. Në fakt, nisur nga sa më sipër, për katin e parë, pagesa sipas çmimi i zonës prej 8954 lekë në këtë ZK duhej të ishte në vlerën 1,217,744 lekë ($136m \times 8954 \text{ lekë} = 1,217,744 \text{ lekë}$) duke shkaktuar një dëm prej $1,217,744 - 516,000 = 701,744 \text{ lekë}$;

-dosja me numër 99999336, datë 29.09.2016 për të cilën ka dalë detyrimi 1,898,190 lekë dhe ka një diferencë në pagesë prej 254,841 lekë, vlerë e cila ulet sipas ligjit nëse fatura do të paguhej brenda 45 ditëve nga marrja e njoftimit, siç shihet në dosje ka 13 ditë vonesë në pagesë;

dosja me numër 99999697 datë 06.4.2017 ku nuk rezulton të jenë shlyer detyrimet për penalitetet e legalizimit të shtesave të subjektit ndërtues në vlerën prej 2% të çmimit minimal fiskal për çdo m² sipërfaqe shtesë për banim 267,788 lekë ($427m^2 \times 31,357 \text{ lekë} \times 2\%$);

dosja me numër 99999347 datë 20.09.2016 për shtesa anësore në një pallat, me sipërfaqe totale prej 236 m² për të cilat nuk rezultojnë të jenë shlyer detyrimet për penalitetet e legalizimit të shtesave të subjektit ndërtues në vlerën prej 2% të çmimit minimal fiskal, për çdo m² sipërfaqe shtesë për banim duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 370,012 lekë

Menjëherë

3. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lushnje të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për llogaritjen, saktësimin dhe *arkëtimin e vlerës 204,760 lekë*, ardhur nga mos aplikimit të penalitetit për lejen e legalizimit nr.00000199, datë 08.08.2017.

Menjëherë

4. Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lushnje të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për llogaritjen, saktësimin dhe arkëtimin e vlerës **379,419 lekë, në përputhje me kërkesat** e Ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar ardhur nga mos aplikimit të penalitetit për lejen e legalizimit me nr.99998650, datë 29.01.2016.

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE

Në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan.

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93 dhe të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën" nga ana e titullarit të njësisë publike, (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohej në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit nga personat e subjektet përgjegjëse. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare, me qëllim për shpërblimin e dëmit në vlerën 3,526,942 lekë të ardhura të munguara, si më poshtë:

1. Rekomandim Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të shtojë në kufizimin krahas kredisë bankare dhe për mos shlyerjen e detyrimeve financiare taksës ndikimit infrastrukturës në vlerën **647,230 lekë** për objektin e ri, deri në sigurimin e vërtetimit të pushtetit vendor, për pasurinë nr. 15/363, ZK 8523, lagjia "Hekurudha.

Menjëherë

2. Rekomandim: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan të marrë masa, në bazë të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara sipas referencës nr.04260, në ZK 8522, deri në arkëtimin e detyrimit të qirasë në vlerën 2,879,712 lekë, konstatuar si rezultat mos përcaktimit të marrëdhënieve të pronësisë së truallit.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

1. Në Drejtorinë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz - Vorë

Mbështetur në neni 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së" të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e kontrollit të lartë të shtetit" në zbatim të Kreu IV, neni 11 germa "d" dhe "e" dhe nenet 37, **141, dhe 153** të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015; ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" të ndryshuar; nenin 9 pika "ç" i ligjit nr. 111/2018, datë 29.12.2018 "Për Kadastrën" si dhe në kontratën individuale të punës **ti kërkohet Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kadastrës Shtetërore**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga "**Vërejtje me shkrim**" deri në "**Largim nga puna**", për këta punonjës:

II. Masa "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna" deri në "Largim nga Puna (zgjidhje e kontratës)", për punonjësit, si më poshtë:

1. Znj. NK, me detyrë specialiste e legalizimit.
2. Znj. MC, me detyrë specialiste e legalizimit
3. Z. BK, me detyrë specialiste e legalizimit.

Menjëherë

2. Në Drejtorinë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier

Mbështetur në neni 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së" të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e kontrollit të lartë të shtetit" në zbatim të Kreu IV, neni 11 germa "d" dhe "e" dhe nenet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETETEVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

37, 141, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 9 pika "ç" i ligjit nr. 111/2018, datë 29.12.2018 "Për Kadastrën", si dhe në kontratën individuale të punës, **t'i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kadastrës Shtetërore**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësive për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga "Vërejtje" deri në "Largim nga puna", për këta punonjës:

a. "Largim nga puna", për punonjësit si më poshtë:

1. z. ER, specialist jurist,

b. "Vërejtje" për punonjësit si më poshtë:

1. znj.AH, me detyrë ish-Regjistruese në ZVRPP,

2. znj.DB, specialiste në ZVRPP:

3. znj. PT, specialiste juriste:

Menjëherë

3. Në Drejtorinë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë

Mbështetur në neni 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së" të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e kontrollit të lartë të shtetit" në zbatim të Kreu IV, neni 11 germa "d" dhe "e" dhe nenet 37, 141, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 9 pika "ç" i ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", si dhe në kontratën individuale të punës, **t'i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kadastrës Shtetërore**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësive për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore "Ndërprerje të marrëdhënieve të punës", për këta punonjës:

"Ndërprerje të marrëdhënieve të punës"

1. LH, me detyrë ish Zv. Regjistruese, aktualisht specialiste hartograf,

2. RA, me detyrë përgjegjës sektori i regjistrimit,

3. LD, me detyrë specialiste,

4. KP, me detyrë specialiste,

Menjëherë

4. Në Drejtorinë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan

Mbështetur në neni 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së" të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e kontrollit të lartë të shtetit" në zbatim të Kreu IV, neni 11 germa "d" dhe "e" dhe nenet 37, 141, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, nenin 9 pika "ç" i ligjit nr. 111/2018, datë 29.12.2018 "Për Kadastrën", si dhe në kontratën individuale të punës, **t'i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kadastrës Shtetërore**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësive për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna" deri në "Largim nga puna", për këta punonjës:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA"

I- Masa "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna" deri në "Largim nga Puna (zgjidhje e kontratës)", për 8 punonjës si më poshtë:

- 1 -Znj. AP, specialiste,
- 2-Z. EGJ, specialist,
- 3-Z. GD, specialist,
- 4-Znj. KSH, specialist,
- 5-Z. EB, specialist,
- 6.znj. EI , specialiste (Juriste),
7. z.ER, specialist,
8. znj.JL specialiste.

Menjëherë

VI. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

Pjesë përbërëse e Raportit të Auditimit është dhe dokumentacioni i mbajtur si më poshtë:

- Akt Verifikim datë 07.12.2018 "Mbi e zbatimit të rekomandimeve" ALUIZNI Sarandë
- Akt Verifikim datë 07.01.2019 "Mbi e zbatimit të rekomandimeve" ALUIZNI Kamëz-Vorë
- Akt Verifikim datë 11.02.2019 "Mbi e zbatimit të rekomandimeve" ALUIZNI Lushnjë
- Akt Verifikim datë 14.01.2019 "Mbi e zbatimit të rekomandimeve" ZVRPP Elbasan
- Akt Konstatimi datë 11.01.2019 "Mbi e zbatimit të rekomandimeve" ZVRPP Fier
- Akt Konstatimi datë 18.01.2019 "Mbi e zbatimit të rekomandimeve" ZVRPP Sarandë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT